

## KONTRATË SHITJE

Sot më datë 11/11/2021 palët pjesmarrëse kanë rënë dakort për lidhjen e kontratës së mëposhtme”

### **PALËT PJESMARRËSE NË KONTRATË :**

**Senad Haxhija**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi J10730110K , lindur më Shkodër, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Shitësi)

**Herald Kapaj**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi J11111062N , lindur më Tirane, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Shitësi)

**Denis Lisha**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I01231053A , lindur më Shkoder, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Blerësi)

### **Neni 1**

#### **OBJEKTI I KONTRATËS**

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave zotëruese nga Senad Haxhija i cili përfaqësojnë 50% dhe Herald Kapaj i cili përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë “**Shqip Ndertim**” me numër unik (NUIS) M12226012P, me adresë Tirane Tirane TIRANË Rruga Komuna e Parisit, zona kadastrale 8570, nr.pasuric 8/883, kadi unik 8270066204.

- Shitjen e kuotës zotëruese nga Senad Haxhija 17% dhe Herald Kapaj 16% ne total 33% të kapitalit të shoqërisë Shqip Ndertim.



**Neni 2**

**Cmimi**



Cmimi i shitjes së 1 (një) kuote e cila përfaqëson 33% të kapitali të shoqërisë "Shqip Ndertim" është 33 000 lek .

### **Neni 3**

#### **Afati i pagimit te cmimit**

Pagimi i cmimit do të kryhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

### **Neni 4**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e shitësit**

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e cmimit ne mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzoje blerësit të gjithë dokumentacionit që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi duhet te garantoje bleresin per gezimin e qetë te kuotave nga cdo e drejtë pronësie të personave të trete. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nese ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve te personave te trete, mbi kuotat objekt i kontrates.

### **Neni 5**

#### **Te drejtat dhe detyrat e bleresit**

1. Bleresi ka të drejtë te kërkojë dokumentat qe vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi kuotat, objekt kontrate nga shitesi nga e nesermja e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate.
2. Bleresi eshte i detyruar të marrë në zotërim vendin ku shoqëria ka qëndrën e ushtrimit të aktivitetit

### **Neni 6**



## Zgjidhja e kontratës

1. Shitesi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhe kontraten kur:

- a) blerësi nuk paguan cmimin.
- b) blerësi nuk merr në dorëzim objektin ku shoqëria ushtron aktivitetin , brenda 15 ditëve nga afati shtesë i caktuar nga shitësi;
- c) blerësi nuk merr në dorëzim dokumentat e pronësisë së kuotave

2. Blerësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur:

- a) shitësi nuk dorëzon dokumentat e pronësisë së kuotave
- b) shitësi nuk dorëzon objektin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, objekt kontrate brenda afatit shtesë 10 ditor, të caktuar nga blerësi ;
- b) shitësi deklaron brenda afatit 10 ditor se nuk do të dorëzojë dokumentacioni dhe objektin e ushtrimit të aktivitetit;

### Neni 7

#### Pasojat e zgjidhjes se kontrates

1. Shitësi me zgjidhjen e kontratës duhet t'i kthejë pagesat e bëra blerësit, dhe gëzon të drejtën për shpërblimin e dëmit .

### Neni 8

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshje midis tyre palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do t'i drejtohen gjykatës se "Rrethit Gjyqësor Tiranë".

### Neni 9

#### Shpenzimet per lidhjen e kontratës



Shpenzimet për lidhjen e kësaj kontrate i ngarkohen te dyja palëve përkatësisht.

#### Neni 10

#### Momenti i kalimit të pronësisë dhe Hyrja në fuqi

Kuotat zotëruese të ortakut Senad Haxhija dhe Herald Kapaj të shoqërinë “Shqip Ndertim” Shpk në datën 11/11/2021 kalojnë në pronësi të **Denis Lisha** si më poshtë:

- Kuota zotëruese nga Senad Haxhija I cili përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë 17 % I kalojn **Denis Lisha** dhe kuota zotëruese nga Herald Kapaj I cili përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë 16 % I kalojn **Denis Lisha** . Në total Denis Lisha 33 % kapital.

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën 11.11.2021

#### Neni 11

#### Hartimi i kontratës

Kjo kontratë u hartua në 2 (dy)kopje nga një për secilën palë.

#### PALËT KONTRAKTUESE

**SHITËSIT :**

**Senad Haxhija**

**Herald Kapaj**

*Senad Haxhija*



*Herald Kapaj*



*Denis Lisha*



**BLERESI**

**Denis Lisha**